

**VENDIM**  
**Nr. 600, datë 9.10.2018**

**PËR MIRATIMIN E SHËRBIMIT**  
**TË SIGURISË PUBLIKE NË 150 INSTITUCIONE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**  
**DHE TË KRITEREVE PËR OFICERËT**  
**E SIGURISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 (njëqind e pesëdhjetë) institucione të arsimit parauniversitar, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, që konsiston në monitorimin nga oficeri i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar të ndërveprimit të vazhdueshëm të nxënësve, personelit mësimor dhe komunitetit.

2. Shërbimi i sigurisë publike në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, siguron:

- a) Përmirësimin e sigurisë faktike dhe të perceptuar në ambientet e shkollave dhe ambientet përreth, nëpërmjet krijimit të figurës së oficerit të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar;
- b) Garantimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit brenda në shkollë si dhe në territorin përreth saj;
- c) Parandalimin e dukurive negative që në gjenezë, duke evidentuar dhe ndërmarrë hapa korrektues, në bashkëpunim me personelin mësimor, psikologun/en e shkollës dhe prindërit;
- ç) Forcimin e bashkëpunimit me oficerët e policimit në komunitet;
- d) Përmirësimin e perceptimit të oficerit të sigurisë të nxënësit dhe të marrëdhënieve ndërmjet tyre e policisë.

3. Akademia e Sigurisë, si institucioni përgjegjës i vetëm për arsimin e lartë policor, që ka për qëllim formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve e të kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit, për personat fizikë dhe juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike, të përgatisë dhe trajnojë oficerët e sigurisë për institucionet e arsimit parauniversitar.

4. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përzgjedhur oficer sigurie janë, si më poshtë vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptarë;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- ç) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- d) Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë;
- dh) Të ketë diplomë të ciklit të dytë ose diplomë të barasvlershme me të në fushën e edukimit, të shkencave sociale, sociologjisë, psikologjisë, drejtësisë;
- e) Të jetë jo më shumë se 40 vjeç;
- ë) Të ketë njohuri të mira kompjuterike.

5. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit, konkurrimit dhe shpallja e rezultateve të konkurrimit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Marrëdhëniet e punës së oficerëve të sigurisë fillojnë pas përfundimit me sukses të trajnimit pranë Akademisë së Sigurisë dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

7. Numri i oficerëve të sigurisë dhe shpenzimet përkatëse përballohen brenda numrit total të punonjësve dhe fondeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

ANEKSI NR. 1

Nr.	Institucioni arsimor	Vendndodhja	Numri i nxënësve
1	“Ismail Qemali”	Tiranë qytet	1720
2	“Ibrahim Rugova”	Kamzë	1477
3	“Sami Frashëri”	Tiranë qytet	1419
4	“P. N. Luarasi”	Tiranë qytet	1291
5	“Qemal Stafa”	Tiranë qytet	1263
6	“Havzi Nela”	Kukës	1207
7	“Shote Galica”	Fushë-Krujë	1134
8	“Janaq Kilica”	Fier	1127
9	“Myslym Keta”	Tiranë qytet	1104
10	“Said Najdeni”	Dibër	1051
11	“A. Z. Çajupi”	Tiranë qytet	1016
12	“Leonik Tomeo”	Durrës	980
13	“Ali Demi”	Vlorë	914
14	“Besnik Sykja”	Tiranë qytet	895
15	“Hydajet Lezha”	Lezhë	885
16	“Partizani”	Tiranë qytet	849
17	“At’Shtjefën Gjeçovi”	Kurbin	833
18	“Naim Frashëri”	Durrës	804
19	“Babë Dudë Karbunara”	Berat	790
20	“Asim Vokshi”	Tiranë	786
21	“Elez Isuf Ndreu”	Kamzë	752
22	“Aleksandër Moisiu”	Kavajë	746
23	“Kostandin Kristoforidhi”	Elbasan	725
24	“Dhaskal Todri”	Elbasan	683
25	“18 Tetori”	Lushnjë	677
26	“Aleks Buda”	Tiranë qytet	676
27	“Jordan Misja”	Shkodër	670
28	“Kostandin Kristoforidhi”	Elbasan	668
29	“Gramoz Palushi”	Paskuqan, Kamzë	666
30	“Skënderbeu”	Has	624
31	“Sinan Tafaj”	Tiranë	621
32	“Hasan Tahsini”	Sarandë	620
33	“Muharrem Çollaku”	Pogradec	614
34	“Isa Adem Boletini”	Tiranë	610
35	“Gjergj Kastrioti”	Durrës	587
36	“28 Nëntori”	Shkodër	584
37	“Ibrahim Muça”	Librazhd	582
38	“Arben Broci”	Tiranë	580
39	“Jordan Misja”	Tiranë	564
40	“Gjergj Pekmezi”	Pogradec	563
41	“Arif Halil Sulaj”	Kurbin	547
42	“Oso Kuka”	Shkodër	543
43	“Asim Vokshi”	Tropojë	522
44	“Bulqizë”	Bulqizë	510
45	“Adem Vrapit”	Roskovec	510
46	“Isa Boletini”	Paskuqan, Kamzë	503
47	“Fuat Babani”	Devoll	501
48	“Shefqet Guzi”	Gramsh	493
49	“Raqi Qirinxi”	Korçë	491
50	“Themistokli Gërmenji”	Korçë	489
51	“Dervish Hekali”	Mallakastër	483

52	“Pjetër Budi”	Mat	466
53	“Skënderbeu” Krujë	Krujë	455
54	“Shejnaze Juka”	Shkodër	451
55	“5 Tetori”	Kuçovë	441
56	“Eqrem Çabej”	Tiranë qytet	441
57	“Olsi Lasko”	Durrës	437
58	“Perikli Ikonomi”	Fier	437
59	“Muhamer Janina”	Berat	431
60	“Ahmet Dakli”	Elbasan	429
61	“Bernardina Qeraxhia”	Durrës	416
62	“Kristaq Capo”	Berat	409
63	“Vasil Kamami”	Elbasan	402
64	“28 Nëntori”	Mat	381
65	“Maqellarë”	Dibër	380
66	“Halit Berzeshta”	Librazhd	377
67	“Sami Frashëri”	Elbasan	374
68	“Zhani Ciko”	Patos	373
69	“Rrëshen”	Mirditë	373
70	“Avdulla Keta”	Tiranë qytet	370
71	“Siri Shaplo”	Gjirokastrë	369
72	“Sherif Hoxha”	Malësi e Madhe	368
73	“Kristaq Capo” Shksh	Berat	366
74	“Miti Zoi Zaka”	Lushnjë	366
75	“16 Shtatori”	Durrës	362
76	“Mustafa Kemal Atatürk”	Peqin	361
77	“Myslim Shima”	Tiranë	359
78	“Shaban Çollaku”	Mat	358
79	“Halim Xhelo”	Vlorë	347
80	“Sandër Prosi”	Tiranë	334
81	“Ramiz Aranitasi”	Skrapar	330
82	“Haxhi Qehaj”	Kavajë	327
83	“Mustafa Hoxha”	Cakran, Fier	323
84	“Mahmut & Ali Cungu”	Elbasan	313
85	“Kutall”	Berat	312
86	“Sami Frashëri”	Përmet	312
87	“Rifat Manjani”	Bulqizë	308
88	“Zihni Magani”	Peqin	306
89	“Kolë Idromeno”	Shkodër	305
90	“Asim Zeneli”	Gjirokastrë	298
91	“Luigj Gurakuqi”	Elbasan	295
92	“Tomorr Sinani”	Elbasan	294
93	“Jani Minga”	Vlorë	274
94	“Maliq”	Korçë	268
95	“Kullë”	Durrës	262
96	“Ibrahim Hasmema”	Tiranë	260
97	“Osman Gjini”	Elbasan	258
98	“Abaz Shehu”	Tepelenë	257
99	Manëz	Durrës	255
100	“Bajram Abdiu”	Kukës	255
101	“Jani Nushi”	Lushnjë	255
102	“Nënë Tereza”	Shkodër	254
103	“Sadik Stvileci”	Tiranë	254
104	“Myslym Shima”	Tiranë	253
105	“Vajdin Lame”	Tiranë	253
106	“Sulejman Delvina”	Delvinë	252

107	“Myrteza Kepi”	Kuçovë	242
108	“Adem Haxhija”	Shkodër	241
109	“Sadi Nuri”	Tiranë	238
110	“Skënderbeu”	Krujë	237
111	“Sali Halili”	Librazhd	235
112	“Milot”	Kurbîn	231
113	“Farkë”	Tiranë	231
114	“Ymer Dishnica”	Korçë	226
115	“Qemal Bazelli”	Pogradec	226
116	“Petro Nini Luarasi”	Kolonjë	225
117	“Pirg”	Korçë	222
118	“Sukth i Ri”	Durrës	221
119	“Kastriot”	Dibër	214
120	“Katund i Ri”	Durrës	214
121	“Mustafa Qemal Atatürk”	Vlorë	213
122	“Loro Boriçi”	Tiranë	212
123	“At’Shtjefën Kurti”	Kurbîn	210
124	“Sabah Sinani”	Pukë	209
125	“Gosë”	Kavajë	207
126	“Miranda Baku”	Elbasan	204
127	“Sulejman Elezi”	Kamzë	204
128	“Anastas Çakalli”	Elbasan	202
129	“14 Engjëjt”	Pogradec	201
130	“Mahir Domi”	Elbasan	200
131	“Llesh Nik Daka”	Lezhë	200
132	“Faik Konica”	Korçë	197
133	“Vath Koreshi”	Lushnjë	197
134	“Fushë-Arrëz”	Pukë	196
135	“Hajredin Fratari”	Mallakastër	193
136	“Hydajet Lezha”	Lezhë	189
137	“Dom Nikoll Kacorri”	Durrës	188
138	“Vaçari”	Tiranë	178
139	“Luz i Vogël”	Kavajë	174
140	“Jovan Ndreko”	Fier	168
141	“Syzes”	Berat	167
142	“Karl Gega”	Lezhë	167
143	“Besnik Hidri”	Durrës	163
144	“Dilaver Nezha”	Librazhd	162
145	“Dodë Kaçaj”	Malësi e Madhe	161
146	“Fiershegan”	Lushnjë	157
147	“Nikollë Zogoriani”	Shkodër	157
148	“Mustafa K. Atatürk”	Kamzë	151
149	“Bubq”	Krujë	150
150	“Muhamet Kondi”	Poliçan	150